Kronikë

Do të shiste armën e zjarrit, arrestohet 23-vjeçari në Tiranë! E kishte fshehur brenda një kutie në formë zemre

Një 23-vjeçar i cili dyshohet se do të shiste armën e zjarrit në kryeqytet është vendosur në pranga. Nga kontrollet e kryera pistoleta me municion luftarak u sekuestrua si provë materiale

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

HOROSKOPI

Redaksia
23 Prill, 10:01 | **Përditesimi: 23 Prill, 10:12**

Share

Tiranë- Një 23-vjeçar i cili dyshohet do të shiste armën e zjarrit në kryeqytet është vendosur në pranga.

Blutë informojnë se i riu u kap në flagrancë në në zonën e Don Boskos, në rrugën "Demir Progni.

Nga kontrollet e kryera pistoleta me municion luftarak u sekuestrua si provë materiale.

LEXO EDHE:
Krujë/ Mbante armë pa leje në biznesin e tij në Bubq, në pranga 68-vjeçari

Ndërkohë nga pamjet e publikuara nga policia shohim se pistoletën 23-vjeçari e kishte mbështjellë me një letër të bardhë brenda një kutie në formë zemre.

Operacioni u kodua 'Gracka'.

Njoftimi i policisë:

Si rezultat i kontrolleve të befasishme, të kryera në vijim të punës policore për garantimin e rendit dhe për goditjen e paligjshmërive, Seksioni i Hetimit të Trafiqeve të Paligjshme, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale, finalizoi operacionin "Gracka".

Gjatë operacionit, u arrestua në flagrancë, në rrugën "Demir Progni", shtetasi A. D., 23 vjeç, banues në Tiranë.

Nga kontrollet u konstatua se ky shtetas kishte me vete 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak, të cilën dyshohet se do ta shiste.

Vijojnë hetimet për të identifikuar dhe nxjerrë përpara përgjegjësisë penale, shtetas të tjerë që mund të jenë implikuar në këtë rast.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: arme zjarri | Tirane

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 23 Prill, 08:20
Si i vlerësoni tonet e përdorura deri më tani në fushatën e 11 majit?
Të qeta | Agresive | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Berisha me gratë në Tiranë: Rama na kopjoi programin, pensionin 200 euro e propozuam ne dhe ai nuk e votoi! I kërkon grave të ikin një muaj nga burrat
23 Prill, 11:32

Vrau fqinjin e tij Xhemal Meta dhe i mori paratë, dërgohet në gjyq Isuf Hasa/ Prokuroria: Viktima u godit me çekiç nga autori pasi kishin pirë kafe së bashku
23 Prill, 11:19

Vrasja e 24-vjeçares palestineze, arrestohet në Liban babai, Fadi Alwan
Sokol Dema
23 Prill, 10:42

Xhixho takohet me qytetarë në Tiranë: Programi ynë ofron një jetë më dinjitoze, ne do të sjellim zhvillimin e vërtetë
23 Prill, 10:05

Rama ndan videon me fëmijët përmetarë: Punimet e tyre do të 'veshin shtëpinë' ku do mbahet Samiti i Komunitetit Politik Evropian më 16 Maj
23 Prill, 08:25

Zgjedhjet/ Gogu në 'Repolitix': PS ka vendosur në listën e hapur kandidatë me peshë elektorale! Në Tiranë marrim 20 mandate deputetësh, prioriteti ynë është BE-ja
22 Prill, 21:37

Tiranë/ Kishin ngecur te 'Shpella e Pëllumbasit', policia u vjen në ndihmë 4 turistëve çekë (VIDEO)
22 Prill, 20:40

Gonxhja merr urimin nga leqjenda e Interit, Zanetti: Të përqafoj Blendi! Gjithmonë 'Forza Inter' (VIDEO)
22 Prill, 18:34

Të shtunën ceremonia mortore për Papa Françeskun, do marrë pjesë edhe Arjan Dodaj! Të enjten në katedralen e Shën Palit meshë në nder të tij
22 Prill, 18:34

Konflikti mes ndërtuesve të jashtë 120 familje në Tiranë, protestë para Ministrisë së Drejtësi: Duam shtëpitë, na i dha gjykata! Manja premton zgjidhje
Joana Preja
22 Prill, 17:44

Morën 2 mijë euro nga biznesmeni që të mos i arrestonin gruan që shkaktoi aksident, GJKKO lë në burg 2 shefat e Rrugores së Tiranës! Mohojnë akuzat
Keti Banushi
22 Prill, 15:40

Gonxhja nga Kombinati takim me komunitetin tropojan: Biseduam për mundësitë e reja dhe zgjidhjen e nevojave urgjente
22 Prill, 15:37

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje